

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2026

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE BUKE,FRUTA, PERIME E TE TJERA PER
KAFSHËT E KOPSHTIT ZOOLOGJIK PËR VITIN 2026”
REF-75994-02-12-2026**

LOTI 2: REF-76008-02-12-2026

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

03221200-6 (perime)

15811100-7 (Buke)

VLERA E FONDIT LIMIT: Blerje bukë, fruta, perime e të tjera për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2026” me fond limit 10.000.000,00 (dhjetë milion) Lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë.

LOTI I DYTË Objekti i prokurimit « **Blerje drithërash, koncentratesh e të tjera për kafshët e Kopshtit Zoologjik**“ Fondi limit **3 614 116.6 (tre milion e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë pike gjashtë) Lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik**, Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI I DYTË; « **Blerje drithërash, koncentratesh e të tjera për kafshët e Kopshtit Zoologjik“ me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj.**

Fondi limit **3 614 116.6**(tre milion e gjashtëqind e katërbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë pike gjashtë) **Lekë pa tvsh**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2.1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

1. **ISO 9001:2015** certifikatën e menaxhimit të cilësisë; Për prodhimin/ tregtimin e produkteve objekt prokurimi ose ekuivalente.
2. **ISO 22000:2018** për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore; Për prodhimin/ tregtimin e produkteve objekt prokurimi ose ekuivalente.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet akreditimi i entit certifikues që ka lëshuar certifikatën ISO.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"i ndryshuar

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e

mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 20% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; **a)** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore dhe të deklaruar në organet tatimore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara,

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm për realizimin e kontratës në profesionet:

- **1 (Një) shofer për transportin e mallrave objekt prokurimi**
(Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, operatori ekonomik duhet të dorëzojë Kontratë Pune, shoqëruar me Leje Drejtimi)
- **1 (Një) punonjës ndihmës**
(Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, operatori ekonomik duhet të dorëzojë Kontratë Pune)

Stafi i deklaruar duhet të rezultojë në listëpagesat e operatorit ekonomik për muajin e fundit.

Shënim: Ky kriter(2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9 të DST**. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

ArgumentimKriteri i mësipërm është në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 4 dhe pika 6 Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e furnizimit, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; është kërkuar me qëllimin që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit dhe realizimit të shërbimit.

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën një mjet transporti ATP, në pronësi/qira/përdorim sipas kontratës noteriale, për të cilin duhet të paraqitet në tender dhe të vërtetohet:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë e mjetit/marrjen me qira/përdorimin me huapërdorje.
- Leje qarkullimi e mjetit.
- Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit.
- Kapaciteti mbajtës.
- Leje higjieno sanitare të mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetin e deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë ushqimet e kafsheve, për cilesinë që duhet të kenë, automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës

2.3.4 Deklarate nga ana e Operatorit Ekonomik Ofertues, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit dhe dorëzimin e mallrave/artikujve objekt prokurimi, pranë Autoritetit Kontraktor, në ditët, oraret dhe sasisë të kërkuara dhe dakordësuara mes palëve.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Aautoritetit Kontraktor .

2.3.5 Me qëllim verifikimin e përbërësve të produktit pellet, Operatori Ekonomik Ofertues duhet të depozitojë, **në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik**, mostra për artikujt e mëposhtëm, ku të specifikohen qartësisht përbërësit e produktit, sipas specifikimeve më sipër.

Në rast të paraqitjeve të konfeksioneve të gatshme (thes / kuti etj.) në konfeksion / ambalazhim të listohen qartësisht përbërësit.

Nëse në konfeksion nuk evidentohen përbërësit ose në rast të ofrimit të artikullit të pa konfeksionuar, OE të depozitojë një dokument vërtetues të përbërësve të produktit që mund të jetë një analizë e realizuara nga një laborator i certifikuar ose një dokument zyrtar i lëshuar nga prodhuesi ku deklarohen përbërësit e produktit.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme në lidhje me elementët përbërës të mëposhtëm për të evituar produkte të panjohura dhe me vlera ushqimore jo cilësore, Duke qenë se objekt i kësaj procedure **janë produkte ushqimore për kafshët e kopshtit zoologjik** me nevoja të vecanta të cilat nuk gjenden lehtësisht dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe zhvillimin e tyre, vlerësimi vetëm mbi bazën e dokumentacionit nuk është i mjaftueshëm. Për këtë arsye, paraqitja e mostrave fizike është e nevojshme për një vlerësim të drejtë, objektiv dhe të plotë.

- Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim.

➤ Mostrat e kërkuara për artikujt me nr. rendor si me poshte (nga nje moster per secilen):

11	Pelet Struc
12	Pelet Kuaj
13	Pelet Lama
14	Pelet Lemurë
15	Pelet Shpend

Mungesa e mostrës është kusht s'kualifikues.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga pesha dhe rëndësia që ato kanë, konkretisht kërkesa për paraqitjen e mostrave për (6) artikujt e mësipërm, për ushqimin e kafshëve konsiderohet e domosdoshme dhe e arsyetuar, pasi: Mundëson verifikimin real të përbërjes, cilësisë dhe karakteristikave ushqyese të produkteve të ofruara; Siguron që produktet përmbushin standardet e nevojshme për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve; Redukton rrezikun e furnizimit me produkte të papërshtatshme ose jo cilësore;

Duke qenë se objekt i kësaj procedure **janë produkte ushqimore për kafshët e kopshtit zoologjik**, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe zhvillimin e tyre, vlerësimi vetëm mbi bazën e dokumentacionit nuk është i mjaftueshëm. Për këtë arsye, paraqitja e mostrave fizike është e nevojshme për një vlerësim të drejtë, objektiv dhe të plotë të ofertave. Për rrjedhojë, kërkesa për mostra është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe përfaqëson një masë të arsyeshme, proporcionale dhe të justifikuar në funksion të interesit publik dhe mirëqenies së kafshëve. Në këtë rast është e rëndësishme për për t'u paraqitur mostra pasi verifikimi fizik i tyre është vlerësuar i rëndësishëm për shkak të funksioneve speciale të produktit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikimet Teknike

2.2.Pellet (koncetrat)

- **Produktet të jenë cilësore, të padëmtuara, pa shenja kalbëzimi, pa era myk dhe të paketuara / konfeksionuara në arka ose konfeksione të gatshme.**
- **Artikujt pellet të jenë të dedikuara për kafshët / shpendët specifike dhe të kenë karakteristikat e mëposhtme:**
 - **Pellet për struca:**
 - a. Pellet 4 mm
 - b. Përmban sasi të ekuilibruar vitaminash, proteinash dhe mineralesh, përfshirë:
 - i. Proteina e papërpunuar
 - ii. Yndyrë e papërpunuar
 - iii. Fibra e papërpunuar
 - iv. metioninë
 - v. kalcium, fosfor, natrium, magnez, zink, jod, selen
 - **Pellet për alpaka dhe lama:**
 - c. Pellet 4mm i pasur me minerale, vitamina dhe fibra.
 - d. Pellet me fibra të larta, me pak proteina me nivele të larta vitaminash dhe mineralesh.
 - e. Përmban sasi të ekuilibruar vitaminash, proteinash dhe mineralesh, përfshirë:
 - i. Proteina e papërpunuar
 - ii. Yndyrë e papërpunuar
 - iii. Fibra e papërpunuar
 - iv. Kalcium, fosfor, magnez, natrium, kalium, Omega 6 dhe Omega-3, hekur, mangan, zink, jod.
 - **Pellet për kuaj:**
 - f. Pellet 6 mm me përmbajtje të ekuilibruar me vitamina dhe minerale për shëndet të mirë dhe riprodhim
 - g. I pasur me vitaminë E me aktivitet antioksidant, nivel i lartë i Biotinës dhe acideve yndyrore esenciale (tipi omega 3),
 - h. Shtuar me vitamin A, D3, E, K3, B1, B2, B6, B12, kalcium, acid folik.
 - **Pellet për lemurë:**
 - i. Pellet 6mm, me përmbajtje të lartë të fibrave, veçanërisht celulozës dhe linjinës (fraksioni ADF).

- j. Me pak niseshte dhe sheqerna, pa drithëra si elbi ose tërshëra e grurit dhe (gruri), pa gluten për të siguruar një tretje të mirë dhe indeks të ulët glicemik.
- k. Me një raport të ekuilibruar të vitaminave dhe mineraleve për një shëndet të mirë
- l. Me përmbajtje zink, mangan dhe bakër për të stimuluar lëvizjen, lëkurën dhe flokët, imunitetin dhe riprodhimin
- m. Përmban vitaminë C në formë të stabilizuar
- **Pellet për shpendë:**
 - n. 2.5 mm, për shpendët e ujit.
 - o. Përmban vitamina shtesë dhe elementë minerale (p.sh. zink dhe selen) për një pamje të bukur të puplave.
 - p. Përmban: faunabiobalance, karotinë, spirulinë.

Menaxhimi nga autoriteti kontraktor

OE është i detyruar të zbatojë procedurat e menaxhimit të ushqimit:

3.1. Operatori ekonomik duhet të ketë kapacitetin e nevojshëm që të kryejë furnizimin me periodicitet javor për të gjithë artikujt e kërkuar në DST.

3.2. AK nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të titullarit do të kryejë procedurën e marrjes në dorëzim për çdo furnizim dhe veprimet për likuidimin e detyrimeve do të rregullohen sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

3.3. OE duhet të shprehë dakordësinë për zbatimin e orareve dhe kushteve të furnizimit në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të AK.

3.4 Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, nga administratori i Kandidatit/Operatorit Ekonomik Ofertues.

NJESIA E PROKURIMIT